

[Data 20/12/2023]

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatit e Bashkisë Tiranë”, i ndarë në lote si më poshtë:**

**Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”**

**Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”**

**Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobuz”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Marrje me qira e veturave të pasagjerëve me shofer 60171000-7; Marrësh me qira e mjeteve të transportit të udhëtarëve me shofer 60170000-0

**Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 353.977.200 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH, i ndarë në lote si më poshtë:**

**Loti 1:** “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 252,325,080 (dyqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e njëzet e pesë mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;

**Loti 2:** “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 84,199,680 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh;.

**Loti 3:** “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobuz”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 17,452,440 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa tvsh.

**Burimi i financimit:** Vënë në dispozicion me fonde që do të parashikohen në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

**Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë: 1 (një) operator ekonomik fitues për secilin lot (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kudër).**

**Një ofertues mund të aplikojë për: të gjitha lotet.**

**Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit: (N/A)/ Nuk do të ketë rihapje konkurrimi.**

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kudër ose afati i zbatimit të kontratës: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga dita e dorëzimit të mjeteve në Bashkinë Tiranë, për secilin lot.**

Afati i levrimit të mjeteve 90 (nëntëdhjetë) ditë pune, termat e leasing 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, për secilin lot.

Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditë pune, për secilin lot. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mjeteve, brenda këtyre afateve.

**Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues për secilin lot.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë, për procedurën me objekt “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatën e Bashkisë Tiranë”, i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”

Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”

Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobuz”

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:**

**Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”**

**Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”**

**Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobuz”**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 (për secilin lot)*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (për secilin lot)*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 (për secilin lot)*

d. *Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2 (për secilin lot)*

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8. *(për secilin lot)*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar e ndarë sipas loteve duhet të jetë si më poshtë:

**Për Lotin 1, jo më e vogël se vlera e pritshme e kontratës/ vlera e përlllogaritur e lotit të parë që prokurohet, përkatësisht 252,325,080 lekë,** lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Për Lotin 2, jo më e vogël se vlera e pritshme e kontratës/ vlera e përlllogaritur e lotit të dytë që prokurohet,** përkatësisht 84,199,680 lekë, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Për Lotin 3, jo më e vogël se vlera e pritshme e kontratës/ vlera e përlllogaritur e lotit të tretë që prokurohet, përkatësisht 17,452,440 lekë,** lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Shënim: PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Loti 1 dhe Loti 2:** Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

*Pika 2/a: .... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlllogaritur për Lotin 1 dhe për lotin 2 janë mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

**Loti 3:** Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

*Pika 2/b.... vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Vlera e përlllogaritur për Lotin 3 është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*Bazuar në nenin 43, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022), të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. *(për secilin lot)*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 (në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. *(për secilin lot)*

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.*

*Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit përkatës, që prokurohet** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: (për secilin lot)

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Shënim: PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar mbi të drejtat e realizimit të furnizimit me llojin e mjetit të ofruar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar me prodhuesin. (për secilin lot)

*-Forma e Dokumentit: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST dhe përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: adresën; telefon/fax; email, website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi. Në rast se Autorizimi nuk përmban këto të dhëna, do të konsiderohet i pavlefshëm.*

*Shënim: Autoriteti Kontraktor gjatë fazës së kualifikimit mund të kryejë verifikimin e të dhënave të paraqitura në Autorizimin e Prodhuesit.*

**Argumentimi:** Referuar nenit 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Si dhe pika 4, [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet*

ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.]

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim të mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

3- Operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimit dhe llojit të mjetit të ofruar, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit/ distributorit zyrtar në këtë kontratë.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/ distributori i autorizuar, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të mjeteve të ofertuara dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të tyre.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në kete proces. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST. (për secilin lot)

**Argumenti:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose” ...

Katalogu/fragment katalogut i mjeteve tregon te dhenat teknike lidhur me pjeses e kembimit, sikurse jane : lloji i mjetit forma, dimensionit,..etj).

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth mjeteve. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë e mjeteve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mjetet e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Së treti, kriteri lidhur me “Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.”, është vendosur pasi, Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës, pra shqip apo anglisht. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim (shqip apo anglisht).

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë/ provojë se ka në pronësi ose me kontratë shërbimi/ bashkëpunimi/ huapërdorje/ qiraje (të vlefshme), auto servis, me qëllim mirëmbajtjen, riparimin apo difekteve teknike të mjeteve gjatë gjithë shtrirjes të kontratës. (për secilin lot)

**Argumentimi:** Në lidhje me këtë kriter vlen të theksojmë se ofertuesit e mundshëm ekonomikë duhet të dëshmojnë se kanë në dispozicion një ambjent auto servis, të pajisur me të gjitha pajisjet fizike të domosdoshme për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve objekt prokurimi, me qëllim që AK të bindet që gjatë kohëzgjatjes së kontratës operatori ekonomik ka aftësinë dhe kapacitetin për të ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen, riparimin apo difekteve teknike të mjeteve gjatë gjithë shtrirjes të kontratës ose përfitimin e shërbimit të servisimit nga operator të tretë.

**Shënim:** 1. a. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Neni 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.

- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

*b. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur*

*2. PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.*

*3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatit e Bashkisë Tiranë”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Argumentim i termave të referencës, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:**

#### **Përfitimet e projektit:**

1. Mënyra e financimit të investimit me blerje ka kosto të lartë financimi në fillim të periudhës, në vazhdim mjetet mbeten pronë e institucionit. Mjetet jemi të detyruar ti mbajmë 10 vjet, kohë e cila kërkon shpenzime materiale për mirëmbajtje dhe procedura administrative gjithashtu. Përvoja jonë ka treguar se këtyre mjeteve nuk u janë bërë shërbimet e duhura parandaluese dhe teknike, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e tyre dhe në garancinë e përdoruesve. Le të shtojmë këtu shpenzime pa fund të nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit. Nga përvoja shpenzimet administrative dhe të spostimit e parkimit janë shumë më të larta se ato të fitimit të skrapit të shitur.

2. Mënyra e financimit Leasing operacional konsiderohet modeli me efektiv i përdorimit të flotave të makinave për qëllime pune në institucione dhe që shfrytëzohen me kapacitet të plotë.

Përhapja e këtij modeli lidhet me avantazhet financiare dhe operative në krahasim me modelet e tjera të blerjes me para në dorë ose të blerjes me anë të kredive nga institucionet financiare.

Këto avantazhe janë të provuara në kohë. Perfeksionimi i industrisë së leasing operacional po i bën këto avantazhe akoma më të dukshme jo vetëm në organizatat jopublike, por edhe në ato publike.



Kompletimi me leasing operacional do të thote dhënie të mjetit duke paguar këstin mujor të qerasë tek qeradhënësi. Pronari i mjetit mbetet qeradhënësi. Shërbimet si: kostot e sigurimit të mjetit, të mirëmbajtjes, taksat rrugore, etj, janë detyrime të qiradhënësit.

Në këtë kuadër, rekomandojmë praktikën e kompletimit të Bashkisë Tiranë me mjete rrugore nëpërmjet marrjes me qera operationale (Leasing), sepse:

1. Menaxhimi i flotës është një detyrë komplekse;
2. Është më e lehtë dhe më ekonomike për institucionin që t'ja besojnë profesionistëve këtë flotë automjete; Referuar eksperiencave të mëparshme lidhur me rifreskimin e inventarit të mjeteve të Bashkisë së Tiranës nëpërmjet blerjes me fonde të buxhetit të shtetit apo dhuratë nga donatorë të ndryshëm, ka rezultuar se nga përdorimi i mjeteve të llojit elektrike kemi një minimizim të shpenzimeve përsa i përket karburantit për këtë tip automjeti, duke marrë në konsideratë se kosto e vetme për këto tip automjete "autovetura elektrike" është shpenzimi i energjisë elektrike për karikimin e baterisë së mjeteve.

### **Avantazhet**

Avantazhet e automjeteve elektrike kanë tendencën të jenë konsiderueshëm më të mëdha se disavantazhet në shumë skenarë, falë natyrës së tyre efçente, sigurisë së shkëlqyer, mungesës së gazrave ndotës dhe benefiteve të tjera, të tilla si:

*Janë më të lira në operim:* Me performimin e llogarive me minimale, një automjet elektrik i kursen një shoferi që përshkon 25,000 kilometra/ vit mesatarisht rreth 1000 Euro.

*Janë ekonomike në aspektin e harxhimit të karburantit,* të shpenzimeve të mirëmbajtjes (kontrolli periodik vaj filtra, ndërrim baterie, pjesë këmbimi goma etj), të shpenzimeve për siguracionin e mjetit, shpenzimeve për kontrollin teknik të automjeteve.

*Karikimi:* Një avantazh edhe më i mirëmenduar i automjetit elektrik është aftësia për t'i karikuar nëpër vendparkim-e. Gjithashtu po bëhet gjithnjë dhe më i mundur karikimi në një stacion-karikimi i makinave elektrike. Mjetet e flotave që karikohen nga sisteme inteligjente karikimi, ofrojnë kursime maksimale shpenzimesh, falë edhe metodave të avancuara të menaxhimit.

Nuk ka zhurmë motorri: Ndotja akustike është e dëmshme për shëndetin publik dhe motorrët me djegie të brendshme të automjeteve që fuqizohen nga benzinë/ naftë, janë nga burimet me faktorë të saj.

*Janë të shpejta:* sepse automjetet elektrikë ofrojnë proporcion superior fuqi-peshë krahasuar me makinat tradicionale.

*Janë më të sigurt:* Prodhuesit e mjeteve elektrike nuk kursejnë asnjë shpenzim në ndërtimin e sistemeve të sigurisë, që është dhe arsyeja pse i kalojnë rregullisht standartet e sigurisë.

*Janë më të thjeshta për t'u mirëmbajtur:* Të gjitha makinat e reja me motorrë me djegie të brendshme kanë një listë të gjatë kosto mirëmbajtjeje, të cilat rrisin shumë shpejt koston totale të mjetit. Mjetet elektrike rezultojnë me kërkesa me më pak kosto mirëmbajtjeje dhe prandaj kostot e mirëmbajtjes janë shumë më të pakta, pasi motorri elektrik ka një pjesë të lëvizshme.

Gjithashtu, kontrolluesi dhe karikuesi janë pajisje elektronike pa pjesë të lëvizshme dhe kërkojnë pak ose aspak mirëmbajtje për autoveturë me 4+1 vende, elektrike.

Nevoja për mjete në secilën strukturë të planifikuar për t'u prokuruar në periudhë afatmesme nëpërmjet formës së financimit me qera operationale, bazuar edhe në buxhetin në dispozicion, është parashikuar për rreth 70 automjete të llojit veturë, 20 mjete Kamionçinë Pick Up, Mikrobuza 5 copë.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për mjete rrugore që kanë strukturat e Bashkisë Tiranë, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e shërbimit.

Mënyra e financimit të investimit me blerje ka kosto të lartë financimi në fillim të periudhës. Për arritjen e këtij objektivi një nga drejtimet kryesore është programimi dhe planifikimi me real i nevojave për mjete levizëse, si dhe krijimi i burimeve të reja në përputhje me kërkesat për këtë shërbim nga strukturat përgjegjëse.

### **Specifikimet teknike**

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

**Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e Termave të Referencës bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit, për procedurën me objekt: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatën e Bashkisë Tiranë”, i ndarë në Lote si më poshtë:**

**Loti 1: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), autoveturë elektrike”**

**Kërkesat teknike për autoveturë elektrike 4+1 vende:**

Viti i Prodhimit	2022-2023
Kilometrazhi	0 km
Motorri	Elektrik
Fuqia Totale	Min 140 KW (190PS)
Kambio	Automatike
Tërheqja	2 X 4
Konsumi i Kombinuar	Max 267 Wh/ Km
Emetimi i Gazrave CO2	0 g/Km
<b>Përmasat e makinës:</b>	
Gjatësia	Jo më pak se 3.600 mm
Gjërësia pa pasqyra	Jo më pak se 1.600 mm
Lartësia	Jo më pak se 1.400 mm
Distanca aksiale	Jo më pak se 2.400 mm
<b>Kabina:</b>	
Numri i dyerve	4 + 1
Numri i vendeve	4 + 1
Tipi i baterisë	Lithium-ion
Kapaciteti Nominal I Baterisë	Jo më pak se 55 KWh
Kohëzgjatja e karikimit I plote prizë normale 0-100%	Jo më shumë se 7 ore
Pesha boshe e makinës	Jo më pak se 1600 kg
Shpejtesia Maksimale	Jo më pak se 130 km/h
Distanca maksimale me një karikim	Jo më pak se 400 Km
Lënda djegëse	Energji Elektrike
<b>Aksesorë shtesë:</b>	
Airbag min 6 cope	
ABS+ ESC+ HAC	
Kontroll Automatik i Dritareve	
Mbyllje qendrore me pult	
Xhamat elektrike	
Dritat elektrike	
Dritat Led	

Ndezje makinës pa çelës	
Timon Multifunksional	
Bluetooth	
Kontroll shpejtësie ( Cruise Control)	
Klimatronik	
Sensor parkimi	
Sistem Kamera(mbrapa)	
Radio me AUX + USB	

\* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### *Kontroll i plotë mbi flotën*

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

#### *Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.*

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operacionale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

#### *Ruajtje e imazhit profesional*

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qera operacionale të një sasive mjeteve rrugore.

### **MËNYRA E OPERIMIT:**

- Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).
- Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me energji elektrike i baterisë së mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.
- I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operacionale.

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:

#### **A. Kërkesa të përgjithshme**

- Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);
- Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;
- Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;
- Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;

- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje;
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkuorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat duhet detyrimisht të jenë ngjyrë e bardhë dhe me logo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

#### **B. Kërkesa të veçanta**

- a. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i 2 (dy) viteve të fundit
- b. Dizenjimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- c. Mjetet që do të ofrohen të jenë të përshtatshme për vendosjen e fenelinave;
- d. Mjetet të jenë të pajisura me konsolle karikimi CCS (combined charging system)
- e. Mjetet të jenë të pajisura me kabull për karikim publik në AC, si dhe kabull rrjeti për karikim në kushte të tjera;
- f. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

#### **Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues**

#### **Loti 2: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Kamionçinë Pick UP”**

##### **Kërkesat teknike për Kamionçinë Pick UP**

Kilometra të përshkruara 0 km

Viti i prodhimit: min 2022

Tërheqja: 2x4 ose 4x4

Numri i vendeve: 4+1 (Katër plus një)

Dyer: 4-5

Motorri: Jo më tepër se 2500 CC

Lloji i Karburantit: Naftë

Kategoria Ambientale: Euro 6

Fuqia: Jo më pak se 145 KF

Kutia e shpejtësisë: Kambio manual ose automatike

Kapaciteti mbajtës: min 200 KG

Dimensionet e Përgjithshme a- Gjatësia: Jo më pak se 5000 mm

Lartësia: Jo më pak se 1800 mm

Gjerësia (pa pasqyra): Jo më pak se 1800 mm

Distanca aksiale: Jo më pak se 3000 mm

Konsumi urban: Jo më shumë se 17L/ 100Km

Konsumi inter- urban: jo më shumë se 9L/ 100Km

Konsumi i kombinuar: Jo më shumë se 11L/ 100Km

Ngjyra e automjetit: e bardhë.

*\* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

##### *Kontroll i plotë mbi flotën*

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkuorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

### *Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.*

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operationale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

### *Ruajtje e imazhit profesional*

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qera operationale të një sasive mjeteve rrugore.

### **MËNYRA E OPERIMIT:**

- a. Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- b. Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).
- c. Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- d. Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me karburant i mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.
- e. I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operationale.

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:

#### **A. Kërkesa të përgjithshme**

- a. Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);
- b. Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë;
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkuorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat duhet detyrimisht të jenë ngjyrë e bardhë dhe me logo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

#### **B. Kërkesa të veçanta**

- a. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i 2 (dy) viteve të fundit
- b. Dizenjimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- c. Mjetet që do të ofrohen të jenë të përshtatshme për vendosjen e fenelinave;
- d. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

**Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues**

### **Loti 3: “Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing), Mikrobus”**

#### **Kërkesat teknike për Mikrobus**

##### *Lloji:*

Automjet ATP me mbyllje hermetike të bagazhit për përdorim të shërbimit DDD

Kambio: Manuale minimumi me 6 shpejtësi ose automatike

Të dhënat e ngarkesës:

Masa maksimale e autorizuar e mjetit: 3000-3300 kg

Masa bruto e ngarkesës: 900-1100 kg

*Të dhënat motorrike:*

Vëllimi e motorrit: 1900-2200 cc

Fuqia motorrike: 75 - 95 kË

Lloji i karburantit: Diesel (naftë)

Numri i pistonave: 4 ose 6

Konsumi mesatar lit/100 km: jo më shumë se 7 litra

Norma e ndotjes: min Euro 6

*Përmasat e jashtme:*

Gjatësia e përgjithshme: 5 300 ÷ 5 500 mm

Gjerësia e përgjithshme (pa pasqyra): 1 900 ÷ 2 100 mm

Lartësia e totale (nga toka): 1 900 ÷ 2 100 mm

Lagësia e akseve: 3 200 ÷ 3 400 mm

*Përmasat e brendëshme të ngarkesës*

Gjatësia e hapësirës së ngarkesës: 1 500 ÷ 1 900 mm

Gjerësia e hapësirës së ngarkesës: 1 700 ÷ 1 900 mm

Lartësia e hapësirës së ngarkesës: 1 400 ÷ 1 600 mm

Vëllimi i ngarkesës (bagazhit): jo më pak se 3.5 m<sup>3</sup>

Dera e pasme: Derë dopio me dykanate me hapje anësore.

Pjesa e ngarkesës: Të jetë e izoluar hermetikisht nga pjesa e pasagjereve

Të dhëna të tjera:

Ngjyra e automjetit: e bardhë

Sistemi i frenimit: ABS ESP

Sistem drejtimi: elektro-hidraulik.

Timoni: në krahun e majtë.

Airbag: Për drejtuesin e mjetit dhe pasagjerin.

Ajëri kondicionuar; Përpara dhe për radhën e dytë të pasagjerëve

Kompjuter bordi: me tregues të shumëllojshëm- konsumi mesatar, km e përshkuara, shpejtësisë,

Kabina e shoferit: Numri i vendeve 5+1 ose 6+1

Auto-Radio: Me portë USB/me komanda në timon, Bluetooth për telefonin.

Senzore parkimi: Përpara dhe mbrapa akustik

Rregullator të shpejtësisë: Sistemi i përzgjedhjes së shpejtësisë konstante (Cruis Controller) ose ekuivalent

Derë anësore me hapje me rrëshqitje në krahun e pasagjerit

Xhamat e dyerve përpara me komandim elektrik

Drita mjegulle përpara dhe mbrapa

Dritat e ditës me llampa LED

Sedilja e drejtuesit me rregullim manual të lartësisë

Mbyllja Qëndrore me pult

Disqet e rrotave: jo më pak se R16 ose ekuivalente

Sistem kontrolli: Monitorimi i presionit të gomave

Çelësa: 2 (dy) kopje.

Automjeti duhet të jetë i pajisur me gomë rezervë, dhe aksesorët për ndërrimin e saj.

*\* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

*Kontroll i plotë mbi flotën*

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkuorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

*Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.*

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operacionale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

*Ruajtje e imazhit profesional*

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qera operacionale të një sasive mjeteve rrugore.

#### **MËNYRA E OPERIMIT:**

- a. Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- b. Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).
- c. Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- d. Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me karburant i mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.
- e. I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operacionale.

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:

#### **A. Kërkesa të përgjithshme**

- a. Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);
- b. Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje;
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkuorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat duhet detyrimisht të jenë ngjyrë e bardhë dhe me logo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

## **B. Kërkesa të veçanta**

- a. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i 2 (dy) viteve të fundit
- b. Dizenjimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- c. Mjetet që do të ofrohen të jenë të përshtatshme për vendosjen e fenelinave;
- d. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

### **Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues.**

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Marrje Mjetesh Rrugore me Qera Operacionale (leasing) për Policinë Bashkiake, Njësitë Administrative, MZSH dhe aparatit e Bashkisë Tiranë”**, për të tre lotet, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*

### **NJËSIA E PROKURIMIT**